

K R I T I K Ë E B I B L I O G R A F I

PALOK DAKA

KONTRIBUT PËR BIBLIOGRAFINË E GJUHËSISË SHQIPTARE (XIII) (1941—1942)

1941

2558. — BARDHYLI (Pseud. i *Llukë Karafilit*): Lushnja dhe fshatrat për rreth sajë... Shih Nr. 2459 (1940).

— Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/185.

2559. — BEN-DEA (Pseud. i *Benedikt Demës*): Reale Accademia d'Italia — Centro di Studi per l'Albania — *Rivista d'Albania*, — Anno II, Fasc. II, Giugno 1940. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Qershuer-Gusht 1941, Vjeti XVII, Nr. 6-8, fq. 358-363.*

Recensione për artikujt e studimet mbi letërsinë e gjuhën shqipe të botuem në fashikullin e II-të *Rev. d'Alb.*

2560. — BIBLIOGRAFI. — *SHKOLLA SHQIPTARE Tiranë Kallnduer 1941, Vjeti IV, Nr. 46, fq. 211.*

Shënime bibliografike e recensione edhe për:

1. Norbert Jokl, *Zur Erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmatien* (Mbi vezgimin (sic) e dialektit shqiptar të Borgo Erizzo-s (sic) në Dalmati).

— Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVI/1943/223.

2. Kolë Kamsi, *Manuale pratico della lingua albanese. Nazioni (sic) grammaticali — Esercizi di conversazione — Vocabolario (sic) albanese-italiano e italiano-albanese* — Shtypshkronja «Kristo Luarasi», Tiranë, 1940. F. 16 — f. 211.

2561. — [BIBLIOGRAFI]. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Kallnduer-Fruer 1941, Vjeti XVII, Nr. 1-2 (mbulesa), Nr. 3-5, (mbulesa), Nr. 6-8, fq. 358-364.*

Njoftime e shënime bibliografike për 55 botime e të përkohshme të ndryshme, ndër të tjera edhe:

1. Seiner, F., *Numri (sic) i parë i popullsisë në Shqypni*, fq. 24.

2. E. Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*. Pj. I, fq. 65.

3. B. Dema, *Për një «Atlant gjuhsuer» të shqypes*, fq. 23.

4. C. Tagliavini, *L'Albanese di Dalmazia*. Contributi alla conoscenza del dialetto ghego di Borgo Erizzo presso Zara. Introduzione, Testi con traduzione interlineare, Lessico etimologico. Firenze, Leo S. Olschki, 1937. Në 8, fq. 316.

5. Carlo Tagliavini, *Linguistica*. Estratti della «Rivista d'Albania», Fasc. II, Luglio 1940; Fasc. IV (1940).

6. Carlo Tagliavini. *Un'operetta sconosciuta della letteratura Calabro-Albanese*. Estratto della «Rivista d'Albania», vol. I (1940).

2562. — [BIBLIOGRAFI]. — *ZÂNI I SHNA NDOUT Shkoder Fruer 1941, Vjeti XXIX, Nr. 2, fq. 63/1-2.*

Njoftime bibliografike, ndër të tjera edhe:

1. J. Rrota, *Analyzimi i rasavet t'ëmnit e zhvillimi historik i tynve.*
2. » *Per historin e alfabetit shqyp, fq. 96.*
3. » *D. Lukë Matranga shkrimtari mâ i vjetri i italo-shqypetarvet (1592), botim i dytë, fq. 30.*
4. » *D. Gjon Buzuku, Monumenti mâ i vjetri i giûhes shqype (1555), Botim i dytë, fq. 58.*
5. F. Seiner, *Numrim i parë i popullsis në Shqypni [toponômastikë], fq. 24.*
6. E. Çabej, *Per gjenezën e literaturës shqipe, Pj. I, fq. 65.*
7. B. Dema, *Per një «Atlant gjuhsuer» të shqypes, fq. 23.*

2563. — BISA KU, GJON: *Rascia Ilirjane ose Kosova Shqiptare. — TOMORI Tiranë 27 Prill 1941, Viti II, Nr. 109, fq. 2.*

Shënime mbi prejardhjen e fjalës *Kosova*. Simbas autorit kjo fjalë për herë të parë u çfaq në shek. XIV (1355) dhe rrjedh nga mbiemni sllav *kos-kosa-koso*, që do të thotë e lakueme, ose: «nji hapsinë me kodrina të vogla e rrethueme me male të nalta», pra me po atë kuptim që ka edhe fjala shqipe *rrafshi*, ose *Rascia e Dardanja*, siç quhej ky vend në kohnat iliriane. Ma poshtë autori shkruen edhe për dyndjet e fi-seve, etj.

2564. — BOGDANI, PJETER: *Cuneus Prophetarum...* Shih Nr. 2468 (1940).

2565. — DEMA, BENEDIKIT: *Shtypi Françeskan në Shqypni...* Shih Nr. 2472 (1940).
— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/139.*

2566. — DILO, LEFTER L.: *Dy fjalë për Mati Logorecin. — SHKOLLA SHQIPTARE Tiranë Mars 1941, Vjeti IV, Nr. 48, fq. 280.*

Nekrologji (shënime biografike).

2567. — DILO, TIMO: *Vdekja e Imzot Pavl Squirò. — TOMORI Tiranë 16 shtator 1941, Viti II, Nr. 230, fq. 2; Nr. 231, fq. 2.*

Nekrologji (shënime biobibliografike. Ilustrohet edhe me një fotografi të P.S.). Ndër të tjera autori shkruen se Pal Skiroi, i cili rizbuloi veprën e Buzukut më 1909, ka krye një studim të plotë mbi këtë vepër: transkribim i Mesharit me komente gjuhësore dhe hartim i fjalorit të plotë të veprës së Buzukut (Në një artikull tjetër të shkurtën me titull *Imzot Pavl Spirò*, i propozohet Min. së Arsimit që të botohet vepra e P. Skirojt mbi Buzukun).

2568. — FISHTA, FILIP: *Gjurmimet e njij mueji në Rromë...* Shih Nr. 2474 (1940).
— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/140.*

2569. — FISHTA, FILIP: *Shqipnija e jonë (Shënime kritike për botimin e artikullit të Fulv Cordignano-s, Misjonár: Shqipnija në historí e në jetë ase pamje panoramike e njij bote së vogël primitive (në RIVISTA D'ALBANIA — Anno II, Fasc I pp. 19-33, «L'Albania nella storia e nella vita ossia visione panoramica di un piccolo mondo primitivo»)). — SHKËNDIJA Tiranë Tetuer 1941, Vjeti II, Nr. 4, fq. 139-154.*

Kritikë kundër artikullit të Kordinjanos. Nëntitujt: I) *Dý të paraqituna të shkrimtarit*, II) *Në gjurmimet e emnavet arbën e arbëni*, III) *Kundërthanëja e pohime të gabueshme*, IV) *Gjurmime karakteri ethnografik*, V) *Gjurmime arheologjike e historí*, VI) *Mbi shtresën thrako-illyrjane ke shqipja — Shtyllat e ndërtesës së Shqipnis së re*.
— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/141.*

2570. — GAETANO Petrotta. — *TOMORI Tiranë 29 Gusht 1941, Viti II, Nr. 215, fq. 3.*
Mbi ftimin e G. Petrotës për të punue në Shqipni (shënime biobibliografike) (shih Nr. 2639)

2571. — GELASIUS (Pseud. i Nikollë Gazullit): Fjalori toponomastik ... Shih Nr. 2403 (1939).
— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/161.*

2572. — GELASIUS (Pseud. i Nikollë Gazullit): *Rivista d'Albania* vj. 1940, bl. IV, fq. 416-424. Shenime Bibliografike, punue prej Prof. Karl Tagliavini. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Shtatuer-Tetuer 1941, Vjeti XVII, Nr. 9-10, fq. 456-460.*
Recension i shënimeve mbi *dialektologji dhe krahazime me gjuhë ballkanike* (shih Nr. 2539).

2573. — GELASIUS (Pseud. i Nikollë Gazullit): **Shkrimtarët Shqiptarë: Libra Shteti** për shkolla të mesme. Nr. 4, Pj. I (1462-1878). Botim i Ministrisë s'Arsmi. Shtypshkronja «Gurakuqi», Tiranë, 1941. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Nanduer-Dhetuer 1941, Vjeti XVII, Nr. 11-12, fq. 545-551.*
Bibliografi e shënime kritike.

2574. — Gj.: Ka vdekë Mati Logoreci. — *VATRA SHQIPTARE Tiranë Fruer Mars 1941, Nr. 16-17, fq. 29.*
Nekrologji.

2575. — GJON ZAVERI (Pseud. i Sterjo Spasses): Prodhimi letrar i vitit 1940. — *SHKËNDIJA Tiranë Kallnduer 1941, Vjeti I, Nr. 7, fq. 49-56.*
Kronikë rreth diskutimit në shtypin e kohës për çeshtjen e gjuhës letrare shqipe dhe shënime bibliografike e recensione për 25 botime (vepra e të përkohshme) të ndryshme.

2576. — ILJADA e Homerit... Shih Nr. 2407 (1939).

2577. — IMPORTANTE riunione al Centro Studi per l'Albania [Mbledhje e randsishme në Qendrën e Studimeve për Shqipninë]. — *TOMORI Edizione italiana Tirana 22 marzo 1941, Anno I, N. 4, fq. 2*
Kronikë në italisht. Ndër të tjera njoftohet se punimet paraprake për mbledhjen e materialit për atlantin gjuhësor të shqipes janë vu në udhë (Shih edhe Nr. 2682).

2578. — KOÇA, VANGJEL: Mati Logoreci. — *SHKËNDIJA Tiranë Fruer-Mars 1941, Vjeti I, Nr. 8-9, fq. 20.*
Nekrologji.
— *Shih edhe C. Tagliavini, «indogerm. Jahrbuch», XXVI/1943/228.*

2579. — KRISTO Dako-ja Pioneri i shqipes dhe i shqiptarismit ndroj jetë. —

VATRA SHQIPTARE Tiranë Nëntor-Dhjetor 1941, Nr. 25-26, fq. 7-8.
Nekrologji.

2580. — KRISTO Dako ndroi jetë. — TOMORI Tiranë 6 dhjetor 1941, Viti II, Nr. 299, fq. 2; Nr. 301, fq. 2.

Kronikë e nekrologji.

2581. — La Morte di Mons. Paolo Schirò [Vdekja e Imz. Pal Skirojt] — TOMORI Edizione italiana Tirana 16 Settembre 1941, Anno I, N. 161, fq. 2.

Nekrologji (Shënime biobibliografike. Ilustrohet edhe me një fotografi. P. Skirò lindi më 25 nandor 1866 dhe vdiq më 14 shtator 1941 në moshën 75 vjeç).

2582. — LAKO, N.: Dobia e bimëvet. Bimët mjaltëprurëse. — TOMORI Tiranë 19 Nandor 1941, Viti II, Nr. 284, fq. 3; Nr. 290, fq. 3; Nr. 296, fq. 3; Nr. 300, fq. 3; Nr. 309, fq. 3; Nr. 319, fq. 3; — 1942, Viti III, Nr. 4, fq. 3; Nr. 12, fq. 3; Nr. 19, fq. 3; Nr. 29, fq. 3; Nr. 38, fq. 3; Nr. 39, fq. 3.

Përshkrim: Vinca minor L. — Metrik i vogël (Korçë), Hedera helix L. — Lerdh-i, lerth-i, urdhe-ja, brushtull-i, longjë-a (Shqip. e Ital.), Taraxacum officinale Krëhër-i (Shqip. e Greq.), lule-gomari (Pogradec); — Erica arborea Shqopë-a, vrik-a (Shqip. e Ital.); Alyssum maritimum Sericë e detit (Mborje), krypësht i detit (Markgraf); Symphytum officinale Kufilmë, kufirëm («Bashkimi» Buseti); Cichorum intibus kore, lkore (Shkoder), bresë (Gjinokastër), rëkore (Shqip. e Greq.); Primulla grandiflora aguliçe (Korçë), lule-dhenjsh (Mokrë), poleskë (Tushemisht), limojsë (Luzje); Borrago officinalis Lëpush, shalje, shaje (Shqip. e Greq.); — Convulvus Arvensis L. Dredhja e arave (Korçë), pëshllizë e arave (Luzje), gëstall i arave (Shpat), Salvia officinalis L. shërbel-i, shërbele-ja (Shkoder), shërbelë-a (Kristoforidhi), surbelë-a (Elbasan), salvi-a (Berat), gjumnesh (Lumë), berunicë (Përmet); Melilotus Alba makth-i (kudo), grunamath-dhi (Kosovë); — Pangratiun maritimum L. iell-i (Shqip. e Ital. lib-i («Bashkimi», zamak-detit, zëmbak-detit); Thymus serpyllum L. zhumbricë-a (Korçë), krastë-a (Shën-Gjergj); Nasturtium officinale Purqaku (Shq. e Ital.); — Humulus Lupulus L. Sumullbar (Zhejë), kempatë (Mulqinet); Corylus Avellana L. Lajthi-a (kudo), funduq-i, leftokar-i (Shq. e Greq.); Buxus Semperviens L. Bush-i (kudo) krishë-a («Bashkimi»), piks-u (Permet); Delphinium Consolida L. gjuhë-ruse (Barç), lule-zog (Luzje); — Tussilaga Farfara Thundër-mushke (Korçë), thunnërz («Bashkimi»), bar-i-petikajt (Shq. e Ital.); Mentha rotundifolia mendër (Toskëri) mennër (Gegëri), najazmë (Korçë); Thymus vulgaris listër (Tomor), lisër, listër (Markgraf), thymar (Shq. e Greq.); Hyssopus officinalis trumzë-a (kudo); Melissa officinalis L. milcë-a («Bashkimi», Cordignano), mickël (Luzje), pselinok (Berat), spelinok (Korçë), shelinok (Berat) (!); Origanum vulgare L. Rigon-i (Toskëri), rigon-i (Shq. e Ital. dhe Greq.) rigonë-a (Cordignano), çaj-i (katund, rreth i Tiranës); — Salvia glutinosa L. mickël e egër (Luzje); Micromeria Juliana Benthii bisht-mi (Lumë); Centaurea Cyanus L. kokoçel-i (Shq. e Greq.) krye-artë? (katund, Korçë); — Spartium junceum L. shpartë-a (Shq. e Greq.), xanë-a (Mallakastër, Berat), gjineshtër (katund, e Tiranës); — Echrium vulgare L. shaljarë-a (Shq. e Greq.); Anchusa Italica, Retz. gjuhë-lopë (kudo), gjuhë lopë (Shq. e Greq.); Sambucus Ebulus L. qingjëlë-a, qëngjëlë (Kristoforidhi), kingël, kingjël («Bashkimi»), qëngjër (Shq. e Ital.); Rubus fruticosus manë-ferrë (Korçë), ferrlagcë, fermacë, yrtytë (Shkoder), lulemane (Dibër); Fagus

Silvatica L. *ah-u* (kudo), *ah-i* (Shkoder), *agj-i* (Cordignano); Cratageus Oxyacantha murris (kudo), *murrizë* (Shq. e Ital.); — Calamintha officinalis Moench *lisen-i* (Markgraf, Shq. e Greq.); Scrofularia Ramossima Lois *bar-boke* (Mëshlë); Lina(?) a vulgaris Mill. *matergan-i* (Shq. e Greq.) *matërganë-a*, *matërgonë-a* («Bashkimi»), *gojasllan i egër* (Korçë); Dipsacus Silvestris Mill. *berunxë* (Dishnicë), *levrë* (Luzje), *shigjetullë* (gjetkë); Petasites vulgaris Desf. *Llopua-oj* (Dishnicë), *rapuh-u* (Kosovë); Cerinthe Minor L. *gurgë-a* (Shq. e Greq.); Myrtus Communis L. *mertë-a*, *myrte-ja* (Shq. e Greq.), *mëret-i* (Shq. i Ital.) *lestinë-a* (Milot i Kavajës), *cimarte-ja* (Nivice Bubanit), *netllë-a* (Linzë); — Lamiun Purpureum L. *lule-ukë* (Tiranë), *lule-shpirto* (Korçë), *lule-qibritkë* (Pogradec); Phlomis Lychnitis L. *çaj-Vithkuqi* (Korçë), *çaj-mali* (Gegëri); Phlomis Fruticosa L. *bezgë-a* (Pojan, Fier), *sfakë-a* (Gjinokastër, Leskovik); Ballota Foetida Lam. *luminjë-a* (Shq. e Greq.), Butomus Umbellatus L. *Bliniq-i* (Shq. e Greq.), *lule-shtërgu* (Rëmbec); Verbena officinalis L. *sporisi* (Polenë), *bar-shpnetkë* (Yzberish), *lule-mine* («Bashkimi»); Polygonum Aviculare L. *bifë-a* (Urshek), *shurrë-kuqe* (Mulqinet); — Verbascum Thapsus L. *bar-peshku* (kudo), *netull* (Mallakastër dhe gjetkë); Eryngium Campestre L. *glëmp-dashi* (Shq. e Greq.); Carduus Nutans L. *kuf-i* (Shq. e Ital.); Carlina vulgaris L. *kërcikuq* (Shq. e Greq.) Fraxinus Ornus L. *frashëri i bardhë* (Ibë); Tilia Platyphylla Scop. *bli-ri*, *bli-ni* (kudo), *lip-i* (Osojë); Rhus Cotinus L. *cërmëdell* (kudo), *strumdell* (Shpat): — Hera-cleum Spondylium L. *sherp-i* (Shq. e Greq. «Bashkimi»), *selin i egër* (Maliq); Inula Dysenderica L. *skarpë-a* (Shq. e Greq.); Vitex Agnus-Castus L. *rrakith* (Elbasan), *ligare kanapicë-a*, *kunupicë* (Shq. e Greq.), *përrojtës* (Rivista «Leka»); Acer campestre L. *krekezë-a* (kudo); Acer Monspessulanum L. *maklen-i* (Korçë).

Në fund autori shkruen se në këtë artikull u përshkruen 62 bimë mjaltëprurëse ku, bashkë me termat shkencore, u dhanë edhe afro 200 emna në gjuhë shqipe, të mbledhuna në vise të ndryshme të Shqipnisë dhe nga shqiptarët e Italisë e të Greqisë. Veç këtyne bimëve, autori përfundon se në truëllin e Shqipnisë ndodhen edhe shumë bimë të tjera mjaltëprurëse.

2583. — LAKO, N.: Shetitje botanike. — TOMORI Tiranë 21 Dhjetor 1941, Viti i II, Nr. 312, fq. 3.

Tiranë — Xhamia e Mulletit. Përshkrim bimësie: *Lugustrum Japonicum* (*Lugustrum vulgare*) *puqllorë* (Ndroq); *Cupressus Sempervirens selvi*, *qiparis*; *Pinus Pinea* L. *kukunare*; *Eucalyptus Amygdalina habill*; *Arum italicum*, Mill. *këlkëza italike*; *Arum Mascutatum* L. *këlkëza pika-lece* (në Korçë); *Erica Arborea shqopa*, *crankth* (Shpat), *sporëng* (Shqip. e Greq.), *kripç*, *kriphth* («Bashkimi»), *brenge thiu* (Lesh), *bizdre-ni* (Nepravtshtë), *bizhgë* (Kurvelesh), *bar'i rebullit* (Tiranë); *Cyclamen neapolitanum*, Ten. *terronda*, *terrondë a pullugjel* (Shq. Ital.) *bukë-derr* (Mulqinet-Vorrë), *burgalem* (Kosovë); *Ruscus Aculeatus rrushkull*, *përce*, *përcezë* (Berat, Tepelenë), *rrushkullore* (gjetkë), *bobokuqe* (Libohovë), *kokokuqe* (P. Tase); *Puerus Ilex ilqe*; *Quercus coccifera pralli* (Shih edhe Nr. 1553, 1916, 2298).

(Shih dhe një version të shkurtuëm në italisht: *Passeggiata botanica* — Tomori Ediz. italiana, Tirana 9 gennaio 1942, Anno II, N. 8, fq. 3).

2584. — MATI Logoreci. — TOMORI Tiranë 2 shkurt 1941, Vjeti I, Nr. 328, fq. 1. Nekrologji.

2585. — MATI Logoreci. — *SHKOLLA SHQIPTARE Tiranë mars 1941, Vjeti IV, Nr. 48, fq. 278-279.*
Nekrologji (shënime biografike).
— Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVI/1943/228.
2586. — MITRUSHI-PANARITI, ILIA: Fjalorthi i Tomori-t. — *TOMORI Tiranë 21 Dhjetor 1941, Viti i II; Nr. 312, fq. 3; Nr. 319, fq. 3; — 1942, Viti III, Nr. 5, fq. 3; Nr. 10, fq. 3; Nr. 12, fq. 3; Nr. 17, fq. 3; Nr. 23, fq. 3; Nr. 29, fq. 3; Nr. 37, fq. 3; Nr. 42, fq. 3; Nr. 49, fq. 3; Nr. 54, fq. 3; Nr. 59, fq. 3; Nr. 66, fq. 3; Nr. 73, fq. 3; Nr. 87, fq. 3; Nr. 92, fq. 3; Nr. 101, fq. 3; Nr. 106, fq. 3; Nr. 114, fq. 3; Nr. 132, fq. 3; Nr. 144, fq. 3; Nr. 170, fq. 3; Nr. 185, fq. 3; Nr. 200, fq. 3; Nr. 202, fq. 3; Nr. 221, fq. 3; Nr. 238, fq. 3; Nr. 254, fq. 3; Nr. 291, fq. 3.*
Botohen 392 fjalë të rralla të sferave të ndryshme, pajisun me shënimet e kuptimit, shembuj e sinonime; disa prej tyre jepen edhe në përkthimin italisht e gjermanisht. Për çdo fjalë shënohet edhe vendi ku asht mbledhun (katunde të rrethit të Korçës, Lushnjës, Elbasanit, Gramshit, Peshkopisë, Pogradecit, Mirditës, Tiranës, Krujës, Matit, Pejë, Skraparit, Pukës, Durrësit, Kolonjës, Burrelit, Bilishtit, Kukësit, Gjinokastrës, Gostivarit, Shkodrës, Shijakut, Përmetit e Dibrës).
2587. — NDOJAJ, INJAC G.J.: Fauna ihtiologjike e Liqenit të Shkodrës. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Shtatuer-Tetuer 1941, Vjeti XVII, Nr. 9-10, fq. 398-409.*
Në këtë studim të shkurtën jepen edhe emnat e 16 peshqëve në shqip dhe latinisht si dhe emërtimi i disa mjeteve të peshkimit.
2588. — PALAJ, BERNARDIN e GURASHI, RROK: Rreth Kishës s'Abatit e fisit të Shalës (Pro manuscriptio). — *HYLLI I DRITËS Shkoder Shtatuer-Tetuer 1941, Vjeti XVII, Nr. 9-10, fq. 370-378; Nr. 11-12, fq. 492-502; — 1942, Vjeti XVIII, Nr. 5-10, fq. 248-266.*
Përmban dhe mjaft elemente të onomastikës (emna njerëzish e vendesh) të kat. Abat të Shalës (Dukagjin) (Shih edhe Nr. 2643).
2589. — PETROTTA, ROSOLINO: La produzione letteraria degli Albanesi d'Italia [Prodhimi letrar i shqiptarëve të Italisë]. — *TOMORI Edizione italiana Tirana 10 Luglio 1941, Anno I, Nr. 104, fq. 2.*
Artikull divulgativ: a) mbi autorë shqiptarë të Italisë që nga Lukë Matranga (1592) e deri tek autorë bashkëkohorë (shënime biografike), etj., b) mbi shkollat e seminarët shqipe të kolonive arbëneshe të Italisë.
2590. — PETROTTA, ROSOLINO: Dhimitër Kamarda. — *TOMORI Tiranë 11 Qershor 1941, Viti II, Nr. 147, fq. 2.*
Artikull biobibliografik (ilustrohet edhe me një fotografi të Dh. Kamardës).
— Shih edhe C. Tagliavini «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/147.
2591. — PETROTTA, ROSOLINO: Il movimento politico-letterario albanese in Italia [Lëvizja politiko-letrare shqiptare në Itali]. — *TOMORI Edizione italiana Tirana 30 Novembre 1941, Anno I, N. 225, fq. 3.*
Artikull divulgativ. Nëntitujt: *Il primo giornale albanese — L'alfabeto albanese unico.*
— Shih edhe C. Tagliavini «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/147.
2592. — QAFEZEZI, ILO MITKË: Italoarbëreshët me Helinoarbëreshët vëllezër të njej vatre. — *TOMORI Tiranë 9 Korrik 1941, Viti II, Nr. 172, fq. 3.*

Shënime mbi prejardhjen e llagapit familjar *Lala* (arbënesh i Italisë). Simbas autorit, origjina e këtij llagapi nuk duhet kërkuar në Shqipëri (as në Mirditë, as në Myzeqe), por në More të Greqisë, prej nga kanë ardhun shqiptarët e Italisë. Ma poshtë autori kumton se në Greqi ndodhet një krahinë me emrin *Lala*, që prej vjetit 1200.

2593. — QAFËZEZI, ILO MITKË: Historia e Italoarbëreshëve me Helinoarbëreshëve e përbashkëtë. — *TOMORI Tiranë* 13 Korrik 1941, Viti II, Nr. 176, fq. 3.

Gjatë shkrimit autori përmend disa llagape të shqiptarëve të Greqisë: *Meksi*, *Buziki*, *Gërbësi*, *Mënësi*, *Bardhi*, *Kriebardhi*, *Panariti*, *Kuçi*, *Karakala*, etj. nxjerrë nga dokumente të shek. XVI, që dëshmojnë për origjinën shqiptare të tyre.

2594. — QAFËZEZI, ILO MITKË: Vatrë katragjyshore të Italoarbëreshëve. — *TOMORI Tiranë* 26 Korrik 1941, Viti II, Nr. 187, fq. 3.

Përmban edhe onomastikë (emna e llagape shqiptare të shek. XVIII).

2595. — QAFËZEZI, ILO MITKË: Falmarayer-i (sic! Recte: Fallmerayer) e dhaskal Kola i Korçës. — *TOMORI Tiranë* 1 Gusht 1941, Viti II, Nr. 192, fq. 3.

Nëntitulli: «Nxitës të vargut të math studimesh mbi helinoarbëreshët — «*Das alb. Element in Griechenland*» dhe «*De Albanensium sive Schkipiter origine et prosopia*» e dhaskal Kolë Nikokliut».

2596. — QAFËZEZI, ILO MITKË: T'i mpruajmë dokumentat gjuhësie e historike. — *TOMORI Tiranë* 10 Tetor 1941, viti II, Nr. 251, fq. 3.

Artikulli mbi nevojën e rrejtjes së dokumenteve të ndryshme (dorëshkrime, etj.) me karakter gjuhësor e historik nga institucione përkatëse, mbasi rrezikohet humbja e tyre.

2597. — RIBEZZO, FRANCESCO: L'originaria area etno-linguistica dello albanese e la sopravvivenza di una parola peonica in Italia [Truelli origjinat etnogjuhësor të shqipes dhe mbijetesat e një fjale peonike në Itali]. — *RIVISTA D'ALBANIA Milano* Giugno 1941, Anno II, Fasc. II, fq. 129-147.

Studim. Në pjesën e parë autori pohon karakterin ilirik të gjuhës së popullsisë së lashtë të Peonisë; në të dytën merr në shqyrtim fjalën **παράβη** (emni i një pijeje), të cilën e zbërthen me ndihmën e shqipes.

— Shih edhe C. Tagliavini, «*Indogerm, Jahrbuch*», XXVII/1948/170-171.

2598. — RIBEZZO, Fr.: Problemi glottologici illirico-albanesi (a proposito di una recensione di C. Tagliavini) [Probleme glotologjike iliro-shqiptare (në lidhje me një recension të K. Taljavinit)]. — *RIVISTA D'ALBANIA Milano* Dicembre 1941, Anno II, Fasc. IV, fq. 334-346.

Në vazhdim të një studimi të botuem (shih Nr. 2529) dhe në lidhje me recensionin e K. Taljavinit (shih Nr. 2607), autori diskuton mbi disa objeksione etimologjike, etj. të K. Taljavinit.

— Shih edhe C. Tagliavini, «*Indogerm, Jahrbuch*», XXVII/1948/171.

2599. — SCHIRÒ, GIUSEPPE: Rassegne bibliografiche. — *Letteratura* [Rrjeshtime bibliografike — *Letersia*]. — *RIVISTA D'ALBANIA Milano* Marzo 1941, Anno II, Fasc. I, fq. 75-81.

Shënime bibliografike e recensione për 8 botime e të përkohshme të ndryshme, ndër të tjera edhe:

1. C. TAGLIAVINI, «*Un operetta sconosciuta della letteratura calabro-albanese*», «*Rivista d'Albania*», III, settembre 1940, pagg. 268 e seguenti. (shih nr. 2540).

2. M. KRUIJA, «*Mëndime mbi trajtimin e një gjuhe letrare shqipe* (Considerazioni sulla formazione di una lingua letteraria albanese) in «*Shkëndija*», Anno I, Nr.2, agosto 1940 (Shih Nr. 2503).

3. N. RESSULI, *Gegërishtja a po Toskërishtja? (Il Ghego o il toscano?)* in «*Shkëndija*» N. 2, pag. 9 e seg. (Shih Nr. 2526).

2600. — SECCHI, CLAUDIO CESARE: «*Ghjella e S. Mëriis Virghjër*» di Giulio Variboba. — *ALBANIA Shqipnë Roma Giugno-Luglio 1941, Anno II, N. 6-7, fq. 420-423.*

Permban edhe shënime biografike për J. Varibobën në italisht.
— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XVII/1948/173.*

2601. — SHERKO, SERGIO: Qualche cenno sull'origine degli Albanesi [Disa shënime rreth origjinës së shqiptarëve]. — *TOMORI Edizione italiana Tirana 20 Ottobre 1941, Anno I, N. 173, fq. 2.*

Përmbledhje mendimesh të çfaquna nga dijetarë të ndryshëm (gjuhëtarë, historianë, arkeologë, etj.) mbi origjinën e shqiptarëve. Autori vetë anon nga mendimi i prejardhjes ilire të shqiptarëve.

2602. — SHULI, ANDREA: Krahazime linguistike në mes gjuhëve ballkanike. — *TOMORI, Tiranë 8 Nandor 1941, Viti II, Nr. 275, fq. 3; Nr. 278, fq. 3; (vazhdimi ndërpritet).*

Botohet teksti jo i plotë i një konference të mbajtur nga autori, në Universitetin e Padovës, rreth teorisë së Fr. Miklosiçit për trajtimin e një tipi të vetëm gjuhësor ballkanik.

2603. — SHUTERIQI, SIMON: «*Vorri i Ashikut*». — *SHKËNDIJA Tiranë Korrik 1941, Vjeti II, Nr. 1, fq. 18-24; Nr. 2-3, fq. 64-70; Nr. 5-6, fq. 189-194; — 1942, Vjeti II, Nr. 7-8, fq. 256-260; Nr. 9-10, fq. 318-322; Nr. 11-12, fq. 369-374.*

Ribotim (botue për herë të parë më 1911) me ndryshime nga varianti i parë, i shkruar në të folmen e Elbasanit. Nën tekstin me titull *Fraseologjia e «Vorrit t'Ashikut»* rrjeshtohen edhe 409 frazeologji.

2604. — SIRDANI, ALEKSANDER: Frazeologji... Shih Nr. 2536 (1940).

— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/173.*

2605. — SIRDANI, MARIN: Shqypnija e Shqyptarët. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Marc-Prill 1941, Vjeti XVII, Nr. 3-5 (179-181), fq. 97-146.*

Studim sintetik mbi shtrimjen etnike të Shqiptarëve. Jepet edhe një përmbledhje e trajtimit të problemit mbi origjinën e shqiptarëve si mbasardhës të ilirëve e trakëve. —

— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/150.*

2606. — STËRMILLI, HAKI: Sami Frashëri. — *TOMORI Tiranë 4 korrik 1941, Viti II, Nr. 168, fq. 3.*

Artikull biobibliografik («*Shqiptarët nëpër shekuj*»).

2607. — TAGLIAVINI, CARLO: Rassegne bibliografiche *Linguistica* [Rrjeshtime bibliografike — *Gjuhësia*]. — *RIVISTA D'ALBANIA Milano Giugno*

1941, Anno II, Fasc. II, fq. 181-190; Fasc. III, fq. 277-285; Fasc. IV, fq. 397-413.

Shënime bibliografiko-kritike e recensione:

— FASCICOLO II [Fashikulli II] fq. 181-190.

Bibliografia — Storia dell'Albanologia [Bibliografi — Histori e Albanologjisë]:

1. A. ALFÖLDI, *Bibliographia Pannonica V. A rómaikori Magyarország és a népvándorlás kutatásának új irodalma 1938-és 1939-ben*. Bibliographia Pannonica V — Die neue Literatur über die Römerzeit und die Epoche der Völkerwanderung in Ungarn aus den Jahren 1938 und 1939, Budapest, Inst. f. Münzenkunde und Archäologie, 1940, in 8°, pagg. 69 (Dissertationes pannonicae I, 10).

2. F. DÖLGER, *Die Leistung der deutschen Wissenschaft für die Erforschung des Balkans im letzten Jahrhundert*, München 1940, in 16°, pag. 16 (estratto da «Deutsche Kultur im Leben der Völker» Mitteilungen der Akademie zur Wissenschaftlichen Erforschung und zur Pflege des Deutschtums, 2-tes Heft, Jahrgang, 1940).

3. N. JOKL, *Albanisch*, in *Indogermanisches Jahrbuch* vol. XXIV, Berlin 1940, pagg. 209-266.

Scritti di carattere generale (Shkrime me karakter të përgjithshëm):

4. G. BONFANTE, *Ancora il carattere satem del Tracio* nella «Revue des études indo-européennes», II (1939), pagg. 61-63.

5. N. BORGIA, Jeromaco, *La lingua albanese*, Roma, Fratelli Palombi, 1940, in 8°, pag. 6 (estratto dalla rivista «Accademie e Biblioteche d'Italia», Anno XIV, Nr. 4).

6. E. ÇABEJ, *Volkstum und Volksname der Albaner* in «Leipziger Vierteljahrschrift für Südosteuropa» IV (1940), pagg. 78-95.

7. F. CORDIGNANO, *Civiltà italiana nel mondo: In Albania* (Roma) Società Nazionale «Dante Alighieri», s.a. (1940) in 16°, pagg. 119. (Nga kjo vepër Taljavini recensionon vetëm kap. III «Sono Illiri gli Albanesi?» (fq. 27-35), në të cilin Kordinjano futet në argumente gjuhësore).

8. BENEDIKT DEMA, *Per një «Atlant gjuhsuer» të shqypes* nella rivista «Hylli i Dritës», XIV (1940), 110-130 (Shih Nr. 2471).

9. *Instituti i Studimevet Shqiptare i temelatës «Skanderbeg» — Ma i pari kuvend i Studimevet Shqiptare* Tirana 9-13 aprile 1940, in folio, pagg. 61.

10. F. RIBEZZO, *Premesse storico-linguistiche sull'autoctonia illirica degli albanesi* nella «Rivista d'Albania» I, (1940), pagg. 114-141 (Në fq. 285 të R. d'A. gjëndet edhe një rektifikim i autorit) (Shih Nr. 2529, 2598).

11. J. SCHNETZ (scritto erratamente Schmetz), *A kje ilirishtja një gjuhë kentum a por një gjuhë satem?* (L'illirico era una lingua kentum o una lingua satem?) nella rivista «Hylli i dritës», XVI (1940), pagg. 216-219 (shih Nr. 2531).

12. P. SKOK, *Osnovi romaniske lingvistike* (Fondamenti di linguistica romanza, in croato), I. *Kulturhistorijski i opći lingvistički problemi i historijska fonetika naglašenih romanskih vokala* (Problemi storico-culturali e linguistici generali e fonetica storica delle vocali toniche romanze) Zagreb, 1940, in 8°, fq. 279, vol. II *Historijska fonetika romanskih jezika* (Negaglašeni vokali i konsonanti) (Fonetica storica delle lingue romanze [vocali atone e consonanti]), Zagreb, 1940, in 8°, pagg. 192+4 carte; vol. III *Historijska morfolologija romanskih jezika* (Morfologia storica delle lingue romanze), Zagreb, 1940, in 8°, pagg. 212.

— FASCICOLO III [Fashikulli III] fq. 277-285.

Fonetica (Fonetikë):

13. M. BARTOLI, *I riflessi di AFFLARE e CONFLARE nell' Italia meridionale* — *Questioni di metodo*, in «Atti della R. Accademia delle Scienze di Torino», Volume LXXV (1939-40), pagg. 44 in 16°.

14. M. BARTOLI, *Una norma dell'albanese e del greco e la questione delle velari ario-europée* in «Rivista d'Albania» I (1940), pagg. 234-260 (Shih Nr. 2461).

Ortografia

15. O. MYDERRIZI, *Vërejtje e rregulla për orthografin e shqipes* (Osservazioni e regole per l'ortografia albanese) in «Shkolla Shqiptare» III (1940) pagg. 400-402 (Shih Nr. 2511).

16. O. MYDERRIZI, *Emnat* (I nomi) in «Shkolla Shqiptare» III (1940) pagg. 457-458. (Shih Nr. 2511).

Morfologia [Morfologji]:

17. ABIDIN FEIZI, *Grammatica albanese* (Pubblicazioni del R. Istituto Superiore Orientale di Napoli) Roma, Edizioni universitarie (sulla copertina: 1940); pagg. 258 in 8°.

Lessico [Leksik]:

18. ABIDIN FEIZI, *Manuale di conversazione italo-albanese* (Manuali linguistici del R. Istituto universitario orientale di Napoli, 30), Roma, Edizioni Universitarie 1940, in 8°, pagg. 135).

19. H. KRAHE, *Beiträge zur illyrischen Wort- und Namenforschung* nelle *Indogermanische Forschungen* LVII (1939), 113-133.

20. (A. LACALENDOLA), *Dizionario Italiano-Albanese e Albanese-Italiano* Novi Ligure, Ed. Guide turistiche, 1940, in 32° pagg. 297.

21. A. MAYER, *Illyrisches* nella *Zeitschrift für Vergleichende Sprachforschung* LXVI (1939) pagg. 75-127.

Toponomastica (Toponomastikë):

22. GELASIUS (Pseudonimo di Don N. Gazulli) *Fjalori toponomastik* (Vocabolario toponomastico) in *Hylli i dritës* XVI (1940) 47-53; 135-144; 240-244; 355-361, 516-522. (Shih Nr. 2403).

23. D.J. GEORGAKAS, *τό τοπωνύμιον Κόριτζα* in *Ηπειρωτικά* XII (1937) 180-184.

24. D.J. GEORGAKAS, *Περί τοῦ τοπωνυμὸν Μαλεβός* in *Byzantinische Zeitschrift* XXXIX (1939) 341-348.
— FASCICOLO IV [Fashikulli IV] fq. 397-413

Questione della lingua letteraria [Çështje të gjuhës letrare]:

25. M. KRUIJA, *Mëndime mbi trajtimin e një gjuhe letrare shqipe* (Considerazioni sulla formazione di una lingua letteraria albanese) in *Shkëndija* I (1940) fasc. 2, pagg. 3-8 (shih Nr. 2503)

26. N. RESSULI, *Gegërishtja a po Toskërishtja?* (Il ghego o il toscano?) in *Shkëndija* I (1940) fasc. 2, pagg. 9-18 (Shih Nr. 2526)

27. N. RESSULI, *Përpyekje të herëshme e të vona për një gjuhë shqipe të përbashkët*. (Tentativi d'una volta e d'adesso per una lingua albanese comune) in *Shkëndija* I (1940) fasc. 4, pagg. 17-32 (shih Nr. 2528).

Dialettologia [Dialektologji] :

28. N. JOKL, *Zur Erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmazien* (Aus Anlass von Carlo Tagliavini, «L'Albanese di Dalmazia», Firenze, (1937), in *Archivum Romanicum* XXIV (1940) pagg. 101-137.

29. P. DONAT KURTI, *Prralla kombtare mbledhë prej gojës së popullit*, Ble I (Fiabe nazionali raccolte dalla bocca del popolo, fasc. I), Shkoder, Shtyp. Franceskane, 1940, in 8° pagg. VIII-191.

30. *Folklorë përmbledhje vrojtimesh permby zakonet edhe gjiuhen popullore të botueme në revistën «Leka» nder 11 vjetet e para* (Folklore, raccolta di osservazioni sui costumi e la lingua popolare pubblicate nella rivista «Leka» negli 11 primi anni) I. *Zakone e doke* (Usi e consuetudini), II. *Nder male tone* (sic), *kerkime t'A. Gjon Karmës, S.J. nder male të Veriut* (Nei nostri monti, ricerche di P. Giovanni K.S.J. nei monti del Nord), III *Kangë e vajtime* (Canti e lamenti funebri) Shkoder, shtyp. «Zoja e Paperlyeme», 1940, in 8°, pp. 118, 271, 133.

31. GIUSEPPE SCHIRO, *Te dhëu i hujaj — Poema in lingua albanese con traduzione letterale italiana dell'Autore*, Palermo, Scuola tip. «Boccone del Povero», 1940, in 8°, pagg. XXI-405.

32. P. SKOK, *Lingvistička proučavanja neslovenskog stanovništva Skopske kotline* (sottotitolo francese: *Etude linguistique de la population non slovène* (sic! recte: *non-slave*) *des alentours de Skoplje*) in *Godišnjak Muzeja Južne Srbije*, I (1941) pagg. 209-230 (in serbo con riassunto francese).

Rapporti con le altre lingue balcaniche [Lidhje me gjuhët e tjera ballkanike]:

33. ANTON BALOTA, *Le problème de la continuité — Contributions linguistiques*, Bucarest, Tiparul universitar, 1941, in 16°, pp. 126.

34. F. KARAKAQI, *Përkime ndërmjet elementesh latin të shqipes e të rumanishtes* (Contatti fra gli elementi latini dell'Albanese e del Rumeno) in *Kultura Islame* II (1940), p. 98 (Shih Nr. 2496).

35. T. PAPAHAĞI, *Etimologii*, Bucuresti, 1940, in 8°, pp. 24.

36. VITTORE PISANI, *Geolinguistica e indoeuropeo*, Roma, Bardi, 1940, in 4° gr., pp. 268 (Reale Accad. Naz. dei Lincei, anno CCCXXXVI, 1939, Serie VI, vol. IX, fasc. II, pagg. 113-378).

37. HAR. POLETKANOVIC, *Turski elementi u arumunskom dijalekta* (Gli elementi turchi nel dialetto arumeno; in serbo), Skoplje, Stamp. V. Dimitrievica 1939, in 8°, pagg. 22.

38. SEXTIL PUSCARIU, *Limba română*, vol. I *Privire generală* (La lingua rumena, I — Sguardo generale: in rumeno) Bucureşti Fund. pentru lit. şi artă «Regele Carol» II, 1940; in 8°, pagg. XIV — 475.

39. AL.ROSETTI, *Istoria limbii române*, III, *Limbile slava meridionale* (Storia della lingua romena III. Le lingue slave e meridionali: in rumeno), Bucureşti Pund. regală pentru lit., şi artă 1940, pagg. 140 in 8°.

40. B.E. VIDOS, *Storia delle parole marinarie italiane passate in francese — Contributo storico — linguistico all'espansione delle* (sic) *lingua nautica italiana* (Bibl. dell'Archivum Romanicum, s. II, vol. 24) Firenze, L. Olschki, 1939, 698.

— *Shih edhe C. Tagliavini, «Indogerm. Jahrbuch», XXVII/1948/175.*

Artikull biobibliografik (Shkrue *Me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes tragjike*).

— Shih edhe C. Tagliavini, «*Indogerm. Jahrbuch*», XXVII/1948/152.

2609. — VALENTINI, GIUSEPPE: La migrazione stradiotica nell'onomastica e toponomastica albanese [Dyndja stradiote në onomastikën dhe toponomastikën shqiptare]. — *RIVISTA D'ALBANIA Milano Settembre 1941, Anno II, Fasc. III, fq. 227-238.*

Artikull mbi emigrimin e stradiotëve në dritën e të dhanave të onomastikës. Shkaqet e emigrimit të stradiotëve, autori i shpjegon në mënyrë jo të drejtë *).

— Shih edhe C. Tagliavini «*Indogerm. Jahrbuch*», XXVII/1948/175.

2610. — VALENTINI, GIUSEPPE: Rassegne — *Storia* [Rrjeshtime — *histori*]. — *RIVISTA D'ALBANIA Milano Settembre 1941, Anno II, Fasc. III, fq. 274-275.*

Recension «D. Gasper Gurakuqi: *Zojzi e Gramshi* në Hylli i Dritës, 1940, (shih Nr. 2489).

2611. — VDEKJA e Mati Logorecit. — *SHKOLLA SHQIPTARE Tiranë Mars 1941, Vjeti IV, Nr. 48, fq. 294.*

Kronikë (M. Logoreci vdiq më 7 shkurt 1941, në moshën 74 vjeç).

2612. — VEPRIMTARIA e qendrës së studimeve shqiptare. — *TOMORI Tiranë 25 Mars 1941, Vjeti II, Nr. 81, fq. 3.*

Kronikë mbi veprimtarinë e sektorëve të ndryshëm të qendrës së stud. shqip. pranë akad.ital. në Romë.

2613. — VERDI, TURNO: Saggio di un Regesto storico dell'Albania. — *TOMORI Edizione italiana Tirana 7 Settembre 1941, Anno I, N. 154, fq. 2.*

Recension «P. Fulvio Cordignano e P. Giuseppe Valentini: *Saggio di un Regesto storico dell'Albania*. Scutari, Tip. dell'Immacolata, 1937-40, pp. 106».

2614. — VERDI, TURNO: Regjistër me shënime dokumentash për historinë shqiptare. — *TOMORI Tiranë 9 shtator 1941, Viti II, Nr. 224, fq. 2.*

Përkthimi shqip i recens. shih Nr. 2613.

2615. — XHUVANI, A.: Nji Fjalorth i ri. — *TOMORI Tiranë 17 Dhjetor 1941, Viti II, Nr. 308, fq. 3.*

Recension fjalorthit të Pano Tases. Ma poshtë autori propozon që Fjalori i Kristoforidhit dhe Fjalori i Bashkimit të ribotohen me përkthimin shqip, etj.

1 9 4 2

2616. — AFERDITA (Pseudonim): Zanafillet e emnavet. — *KUMBONA E SË DIELLES Shkoder 21 Qersher 1942, Vjeti V, Nr. 25, fq. 304; Nr. 26, fq. 317; Nr. 27, fq. 329, Nr. 29, fq. 349, Nr. 30, fq. 364, Nr. 33, fq. 401;*

*) Ma gjanë shih edhe: Androkli Kostallari, *Contribution à l'histoire des recherches onomastiques dans le domaine de l'albanais* në *STUDIA ALBANICA*, Tirana, 1965, Nr. 1, fq. 46.

Nr. 35, fq. 421; Nr. 36, fq. 434, Nr. 37, fq. 449, Nr. 38, fq. 460, Nr. 39, fq. 472; Nr. 40, fq. 483.

Në rend alfabetik botohen 194 emna të përveçëm vehtjesh të të dy gjinive, që përdoren në Shqipni, me prejardhje të huej (greke, latine, gjermane, etj.) dhe shqipe.

2617. — ALBUS (Pseudonim): Nji auktor i vjetër dhe nji gabim i ri. — KOHA (Tempo) Romë 22 Tetor 1942, Vjeti I, Nr. 21, f. 29.

Njoftohet se profesori bullgar, Ivan Duičev, i Universitetit të Sofjes, në një konferencë të mbajtur në Padova (Itali), e ka paraqitur autorin shqiptar të «Cuneus Prophetarum», Pjetër Bogdanin, si autor bullgar.

2618. — ALBUS (Pseudonim): Fjalë të reja e neologjizma. — KOHA (Tempo) Romë 5 Nëntor 1942, Vjeti I, Nr. 22-23, fq. 67.

Autori propozon që fjalët e reja dhe neologjizmat e Institutit (shih Nr. 2548) të propagandohen me anë të shtypit dhe të radios dhe të de-tyrohet përdorimi i tyre.

2619. — ALBUS (Pseudonim): Me folë shqip. — KOHA (Tempo) Romë 17 Dhetuer 1942, Vjeti I, Nr. 25, fq. 31.

Mbi nevojën e pastrimit të shqipes nga fjalët e hueja, veçanërisht nga shprehje e konstrukte kalke. Simbas autorit fraza «nji vjet dit», «nji muej dit», etj. që janë futun thellë në shqipet, janë kalke përkat. nga rum. «un an dezilë», kroat. «mjeseć dana», etj.

2620. — ALES (Pseud. i Injac Zamputit): Germa a ndër përgjegjet pëvetse tona. — KUMBONA E SË DIELLES Shkoder 5 Korrik 1942, Vjeti V, Nr. 27, fq. 328.

Vëzhgime mbi përdorimin e zanores a si formë përgjigje dhe ndryshimet kuptimore që rrjedhin nga konteksti dhe intonacioni (P.sh. fjalisë pohuese «Shkova në pazar me ble kumbuj, po nuk gjeta kokrren», i kundërvihet përgjigja «Aa?», etj.)

2621. — ALES (Pseud. i Injac Zamputit): Po-hi e jo-hi ndër bisedë tona (Shënime gjuhsore). — KUMBONA E SË DIELLES Shkoder 19 Korrik 1942, Vjeti V, Nr. 29, fq. 350-351.

Vëzhgime gjuhësore mbi përdorimin në bisedë të ndajfoljes pohuese po dhe të fjalëzave të palakueshme êhêê, fff, etj. që i përgjigjen kuptimit = si urdhnnon, etj. dhe të ndajfoljes mohuese jo e fjalëzave të plk. hêngê, hêkê [hênkhê], cuk, etj. me kuptim mohor.

2622. — BARDHI, PASHK: Emzot Prend Doçi. — HYLLI I DRITËS Shkoder Marc-Prill 1942, Vjeti XVIII, Nr. 3-4, fq. 108-140.

Artikull mbi jetëshkrimin e P. Doçit, themelues i Shoq. «Bashkimi». (Përmban shënime për shoq. «Bashkimi», Kongresin e Manastirit dhe alfabetin e shqipes).

— Shih edhe K. Gurakuqi, «Indogerm. Jahrbuch», XXIX/1951/162.

2623. — BARDHI, PASHK: Përgjegje Z. Lul Shkurtit. — HYLLI I DRITËS Shkoder Maj-Tetuer 1942, Vjeti XVIII, Nr. 5-10, fq. 346-350.

Në lidhje me artikullin «Shenjime rreth alfabetit» të L. Shkurtit (shih Nr. 2661), autori hedh poshtë pohimin se Ndre Mjeda asht autor i alfabetit të aprovuem në Kongresin e Manastirit. Alfabeti i Manastirit,

shkruen A., asht vepër e tanë Kongresit dhe jo e një individi të vetëm. (Shih dhe Nr. 2663).

2624. — BARDHI, PASHK: Faik Konica. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Nanduer — Dhetuer 1942, Vjeti XVIII, Nr. 11-12, fq. 472-480.*

Nekrologji (shënime biografike, kujtime personale dhe fragmente nga letërkëmbimi me F. Konicën).

2625. — BARTOLI, MATTEO: Ancora la norma dell'albanese e del greco e la questione delle velari ario-europee [Edhe një herë norma e shqipes dhe e greqishtes dhe çështja e velareve ario-europiane]. — *RIVISTA D'ALBANIA Milano Marzo 1942, Anno III, fasc. I, fq. 23-30.*

Në vijim të një studimi të maparshëm (shih Nr. 2461), autori kthehet edhe një herë mbi këtë subjekt me këtë përmbajtje: *La norma euristica dell'albanese e del greco* (§ 1) — *La Lex Hirt velari ario-europee* (§ 2). — *La terna dell'Albanese* (§ 3). — *Le due serie di velari ario-europee* (§ 4). (Shih edhe rocens e K. Taljavinit Nr. 2607).

2626. — BAZZOLI, GAETANO: Shqiptarët dhe ilirët. — *TOMORI Tiranë 1 Prill 1942, Viti III, Nr. 78, fq. 3.*

Artikull për etnogjenezën e shqiptarëve si mbasardhës të ilirëvet dhe gjenezën e binomit kombëtar Albani — Shqipni. (Shih edhe versionin italisht: *Albanesi ed Illirici, origini, caratteri, sviluppi di un antico dibattito*. *Tomori* Ediz. italiana, Tirana 4 Aprile 1942, Anno II, Nr. 81, fq. 3).

2627. — BENUSSI, ZEF: Për një gjuhë të përbashkët. — *TOMORI I VOGËL Tiranë 1 Qershor 1942, Viti I, Nr. 11, fq. 2.*

Vrejtje dhe shënime rreth artikullit të N. Resulit (shih Nr. 2696). Autori shton edhe disa sugjerime të vetat në lidhje me dy dialektet kryesore të shqipes. Prek edhe çështjen e ortografisë.

2628. — [BIBLIOGRAFI]. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Kalinduer-Fruer 1942, Vjeti XVIII, Nr. 1-2, fq. 84-96; Nr. 3-4, fq. 186-189; Nr. 5-10, fq. (mbulesa); Nr. 11-12, fq. 480-485; 487-488.*

Njoftime, shënime bibliografike e recensione për 23 botime e të përkohshme të ndryshme, ndër të tjera edhe:

1. Justin Rrota, *Sintaksi i shqipes*, për klasën II, III, IV të K(ursit) U(lët) të Shkollave të Mjesme. Shkoder Shtyp. «A.Gj. Fishta», 1942. Në 16. fq. 141.

2629. — BOGDANI, PJETËR: Cuneus Prophetarum... Shih Nr. 2468 (1940).

2630. — COSTA, PIERO, Kontribute të kronologjisë shqiptare. — *TOMORI Tiranë 20 Tetor 1942, Viti III, Nr. 251, fq. 3.*

Recension vëllimit: Valentini P. Giuseppe, «*Contributi della cronologia albanese*» (337-395 p.Kr.) Vol. I, Roma 1942, faqe 356 me 2 tab. dhe me një hartë gjeografike.

2631. — ÇABEJ, EQREM: Diana dhe Zâna. — *HYLLI I DRITËS Shkoder Kalinduer-Fruer 1942, Vjeti XVIII, Nr. 1-2, fq. 5-11; Nr. 3-4, fq. 144-149; Nr. 5-10; fq. 227-231.*

Studim krahasues. Simbas autorit deri më sot për olimpin ilir dihen këto hyjni, të cilat, në ma të shumtën shënohen me emna latine ose në trajtë fonetike latine: 1) *Diana*, 2) *Liber*, 3) *Libera*, 4) *Armatus*, 5) *Pan-Silvanus*, 6) *Bindus*, 7) *Medaurius*, 8) *Latra*, 9) *Sentona*, 10) *Ica*, 11) *Iria*, 12) *Uridua*, 13) *Melesocus*, 14) *Jutonica*, 15) *Aufanae*, 16) *Juppiter Parthinus*, 17) *Ande nus*, 18) *ἰαλος*, 19) *Apollo Derrônais*, 20) *Juppiter Menzana*, 21) *Versobius*, 22) *Logetis* *Νεσις*, 23) *Grabovius*. Se si quheshin në gjuhën ilire emnat e hyjnive *Diana*, *Liber*, *Libera*, *Armatus*, *Silvanus* e *Juppiter Parthinus*, simbas autorit, vështirë se mund të dihen, kurse për emnat e hyjnive të tjera janë trajtue e dhanë mendime nga dijetarë të ndryshëm. P.sh. emni *Bindus* asht trajtue nga A. Mayer, P. Kretschmer, V. Pisani; për: *Medaurus* nga Tomaschek, R. Peter, C. Patsch; për: *Latra* nga K. Treimer, E. Çabej; për: *Iria* nga Tomaschek, Çabej, Treimer; për: *Apollos Derrônaios* nga Gaebler, Th. Reinach, Çabej. Ma poshtë autori shkruen se emni i hyjneshës *Diana*, që mendohet se në trakisht ka qenë *Bendis* a edhe *Mendis*, në rum. asht *zină* (zînă), aromun. *dzînă*, megleno-rum. *zonë*, rum. e moçme *dzin*, *dzinoin*, etj. Simbas Joklit, *zina*-s rumune në Shqipni i përgjigjet fonetikisht dhe kuptimisht fjalës *zana* të geg. veriore, e cila rrjedh nga fjala *zâ*. Tue e zhvillue ma tej këtë tezë të Joklit, autori shton se *zana* në toskënisht çfaqet në trajtën *zërë* (*zana*-*zëra*), figurë që ka qenë e gjallë në gjithë lamin e gjuhës shqipe.

2632. — DEMA, BENEDIKT: Shtypi Françeskan në Shqypni... Shih Nr. 2472 (1940).

2633. — DOLI «Fjalorthi i ri» i D. Nikollë Gazullit. — *TOMORI Tiranë* 27 Qershor 1942, Viti III, Nr. 154, fq. 2.

Recension i shkurtën «*Visaret e Kombit*» Vëllimi XI «*Fjalorth i ri*» (fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnisë) nga D. Nikollë Gazulli. (Shih edhe recensionet e autorëve të tjerë Nr. 2644, 2655, 2656, 2661, 2674, etj.).

2634. — FAIK Konitza si è spento a Boston. — *TOMORI Edizione italiana* 24 Dicembre 1942, Anno II, Nr. 305, fq. 1.

Nekrologji.

2635. — FJALË të hueja — Fjalë shqipe. — *TOMORI Tiranë* 3 Shkurt 1942, Viti III, Nr. 29, fq. 1.

Nen pseudonimin «Djelmnijs shqiptare» një lexues kërkon të zavendësohen një numër fjalësh të hueja që ndeshen në shtyp e në radio: *avenir*, *rezistojnë*, *avancojnë*, *modeste*, *servir*, *decisive*, *interpret*, *gravitet*, *prudencë*, *presjon*, *tendencë*, *ambient*, *influcencë*, *atrecurturë*, *violencë*, *konsolidohet*, *aktualisht*, *evidentalisht*, *leçitasjon*, *manjifik* e *koshjent*, për të cilat jepen fjalët korresponduese shqipe.

2636. — (FRASHËRI, SAMI): «Fjalor historik». — *TOMORI Tiranë* 28 Korrik 1942, Viti III, Nr. 180, fq. 3; Nr. 181, fq. 3; Nr. 241, fq. 3; Nr. 242, fq. 3; Nr. 243, fq. 3; Nr. 245, fq. 3; Nr. 247, fq. 3; Nr. 254, fq. 3; Nr. 259, fq. 3; Nr. 260, fq. 3; Nr. 261, fq. 3; Nr. 265, fq. 3; Nr. 266, fq. 3; Nr. 269, fq. 3; Nr. 277, fq. 3; Nr. 278, fq. 3; Nr. 279, fq. 3; Nr. 300, fq. 3.

